

UDHËZUES I SHKURTËR

NDERVEPRIMI DIGJITAL I KËSHLLIT ME QYTETARËT PERMES NDERFAQES SE INTERNETIT

NË KUADËR TË KËSHLLIT DIGJITAL

Tiranë, Maj 2021

Ekspert: Artan Rroji

Tabela e përmbajtjes

PARATHËNJE	3
QELLIMI I UDHËZUESIT	3
HYRJE	4
KOMPONENTË E QEVERISJES DIGJITALE.....	7
e-Transparenca	8
e-Pjesëmarrja dhe e-Konsultimet	10
e-Shërbimet	12
e-Llogaridhënja	13
QEVERISJA E KESHILLIT PER ZHVILLIMIN E KESHILLIT DIGJITAL	13
Shtojca nr. 1 - Model program i transparencës së këshillit bashkiak.....	16
Shtojca nr. 2 - Elementët kyç të programit elektronik të transparencë së këshillit.....	20

PARATHËNJE

Udhëzuesi hartohet në kuadër të projektit “Bashkitë të Forta, zbatuar nga Helvetas Swiss Intercooperation dhe i financuar nga Swiss Development Cooperation (SDC), Zvicër. Ky

Ky udhëzuesi është pjesë e kurrikulës së trajnimit “e- Këshillave Bashkiakë në Partneritet me Qytetarët”, trajnim që organizohet nga Shoqata e Qarqeve të Shqipërisë, në kuadër të projektit “Bashki të Forta”, dhe synon fuqizimin e rolit qeverisës dhe përfaqësues të këshillave bashkiak të Shqipërisë, si dhe të fuqizojë rolin e Shoqatës si interlokutor me këshillat bashkiakë, në krijimin e rrjeteve rajonale të këshilltarëve me karakter tematik dhe advokues.

Grupi që synon ky udhëzues janë këshilltarët bashkiakë në përgjithësi, si dhe kryetarët dhe sekretarët e këshillave bashkiakë në veçanti.

Projektit “Bashki të Forta” ka mbështetur këshillat bashkiakë me rritjen e kapaciteteve të këshilltarëve dhe stafeve të tyre dhe me kapacitete teknologjike dhe të infrastrukturës së teknologjisë së informacionit; ka ofruar mbështetje institucionale dhe rregullatore, për t’i mundësuar këshillave të luajnë në mënyrë efektive rolin e tyre përfaqësues, politikëbërës, vendimmarrës dhe mbikqyrës në përputhje me kërkesat ligjore, pritshmëritë dhe nevojat e qytetarëve.

Në këte kuadër, “Bashkia të Forta” kanë mbështetur këshillat bashkiakë me model rregullor dhe model struktural të sekretariatit të këshillit, të cilat u konsultuan përmes dhe më pas iu shpërndanë këshillave nëpërmjet Agjencisë për Mbështetjen e Qeverisjes Vendore (AMVV); në hartimin e planeve vjetore të punës dhe të buxheteve vjetore të këshillit; në regjistrimin, hapjen dhe transmetimin online të mbledhjeve të këshillit, përgjatë periudhës së pandemisë dhe në vazhdim; në zhvillimin dhe popullimin me të dhëna të ndërfaqeve të internetit të këshillave, etj. Programi ka mundësuar atashimin e mentorëve pranë këshillave për t’i ndihmuar drejtuesit dhe organet e këshillave në ushtrimin efektiv të veprimtarisë së tyre.

QELLIMI I UDHËZUESIT

Qëllimi i këtij udhëzuesi të shkurtër është të paraqesë para këshilltarëve bashkiakë një pëmbledhje të koncepteve dhe komponentëve të qeverisjes digjitale të këshillit, si dhe të detyrimeve ligjore, rregullatore si dhe të procedurave që duhet të ndjekë këshilli në lidhje me ndërveprimin digjital me qytetarët në funksion të qeverisjes së mirë, për të zhvilluar njohuritë dhe nxitur iniciativën e këshilltarëve për të avancuar standartet e zhvillimit dhe përdorimit të platformave dhe teknologjisë TIK.

Udhëzuesi paraqet aspekte të zhvillimit dhe përdorimit të ndërfaqes së internetit të këshillit si një platformë për qeverisje digjitale që ofron këshilli, dhe që mundëson transparencën, pjesëmarrjen, konsultimin, shërbimet dhe llogaridhënjen digjitale ndaj qytetarëve, në një mjedis të ndërveprimin digjital me ata.

HYRJE

E drejta e qytetarëve për të marrë pjesë në qeverisjen vendore dhe drejtimin e çështjeve publike vendore bën pjesë në parimet e përbashkëta të shteteve demokratike, dhe ushtrimi i kësaj të drejte në mënyrë sa më të drejtpërdrejtë rrit dhe fuqizon demokracinë vendore dhe garanton një vendimmarje sa më afër interesave, nevojave dhe pritshmërive të qytetarëve.

Demokracia vendore pasurohet nga pjesëmarrja aktive e qytetarëve dhe grupeve të interesit në qeverisjen vendore dhe më së pari mundësohet nga qeverisja e mirë vendore.

Misioni i këshillit bashkiak në bashkë-qeverisje është të garantojë funksionimin e Këshillit si një organ vendimmarrës përfaqësues, të mirë informuar dhe të përgjegjshëm, të zhvillojë komunitetin vendor dhe burimet e tij në një mënyrë të përgjegjshme shoqërore dhe mjedisore, si dhe të sigurojë që shërbimet dhe facilitetet publike vendore t’i përgjigjen në mënyrë efektive nevojave të komunitetit. Ato kanë në misionin e tyre edhe nxitjen efektive të pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse të bashkësisë në qeverisjen vendore,¹ detyrimin të garantojnë pjesëmarrjen e publikut në procesin e vendimmarrjes², të marrin në shqyrtim kërkesat e qytetarëve dhe t’u kthejnë përgjigje brenda afateve të përcaktuara me ligj³, si dhe detyrimin të pranojnë dhe të shqyrtojnë iniciativat qytetare për vendimmarje bashkiake.⁴

Për të garantuar zbatimin e detyrimeve ligjore dhe mundësuar ushtrimin e të drejtave të qytetarëve në qeverisjen vendore, si dhe për të rritur cilësinë dhe rezultatet e qeverisjes, këshillat bashkiakë duhet të synojnë të demokratizojë sa më shumë qeverisjen vendore dhe të krijojnë një mjedis të favorshëm dhe inkurajues për pjesëmarrje sa më të gjërë, aktive dhe të efektshme të qytetarëve, si dhe të vënë në dispozicion të qytetarëve mjete dhe teknologji bashkëkohore.



¹ Neni 7/ 2 i Ligjit nr. 139/2015; Rregullorja e Brëndshme e Funksionimit të Këshillit

² Neni 16/1 i Ligjit nr. 139/2015; Rregullorja e Këshillit për Marrëdhënjet me Publikun

³ Neni 19/2 I Ligji nr. 139/2015; Rregullorja e Këshillit për Ankesat, Kërkesat, Peticionet dhe Iniciativat Qytetare

⁴ Neni 20/1 i Ligji nr. 139/2015; Rregullorja e Këshillit për Peticionet dhe Iniciativat Qytetare

Bashkitë përfitojnë shumë nëse komunitetet vendore dhe shoqëria civile janë dinamike dhe pjesëmarrëse, dhe për këtë arsye ato duhet t'i ndërgjegjësojnë dhe inkurajojnë ata, të lehtësojnë qasjen e tyre në informacion, të dhëna të hapura, në procese pjesëmarrëse të këshillit, t'i fuqizojnë ato duke shtuar njohuritë, aftësitë dhe ngritur kapacitetet e tyre, në mënyrë që këshillat dhe qytetarët të ndërtojnë sëbashku një bashkëqeverisje efektive.

Këshilli me vendimmarrje dhe veprimtarinë e tij transparente, pjesëmarrëse, të hapur dhe përfshirëse kontribuon në qeverisje të mirë dhe në interesin më të mirë të publikut, duke rritur kështu besimit e publikut ndaj qeverisë bashkiake në përgjithësi dhe këshillit bashkiak në veçanti.

Për të mundur zbatimin e misionit të tyre qeverisë, sipas kërkesave ligjore dhe në mënyrë efektive, këshillat bashkiakë duhet të përqafojnë shpejt avancimet e teknologjisë së informacionit në kryejën e punëve të tyre dhe në ndërveprimin me të përfaqësuarit, pra të rrokin praktikatat e qeverisjes digjitale.

Zhvillimi i qeverisjes digjitale është një përparësi në rritje, në agjendat politike, por vëmendja është përqendruar kryesisht në transformimin dixhital të qeverisë në nivelin kombëtar. E-qeverisja lokale meriton vëmendje gjithashtu sepse administratat e qytetit dhe komunave kanë ndërveprim më të drejtpërdrejtë me banorët dhe janë përgjegjës për adresimin e shqetësimeve që ndikojnë në jetën e përditshme të njerëzve.⁵

Që transformimi dixhital i qeverisë të ketë sukses, teknologjitë dixhitale duhet të përfshihen plotësisht dhe që nga fillimi, në proceset e hartimit të politikave dhe dizenjimit të shërbimeve. Sektori publik duhet të dizenjohet për të qënë dixhital. Kjo nënkupton mobilizimin e teknologjive dhe të dhënave ekzistuese dhe atyre në zhvillim për të rimenduar dhe ri-inxhinieruar proceset e punëve dhe operacionet e brendshme. OECD (2020), përcakton gjashtë dimensionet e një qeverie të plotë dixhitale: 1- E dizenuar për të qënë digjitale, 2- Sektor publik i drejtuar nga të dhënat; 3- Qeveria si platformë, 4- E Hapur, si rregull, 5- Të nxitur dhe drejtuar nga përdoruesit, 6- Proaktive.⁶

Ndërveprimi digjital mes këshillit dhe këshilltarëve bashkiakë nga njëra anë dhe qytetarëve nga ana tjetër, është tashmë një realitet në fushën e qeverisjes vendore, dhe këshilli ka rolin kyç në avancimin e një axhende të digjitalizimit të këtij ndërveprimi, krijimin e kornizës strategjike, rregullatore dhe garantimin e burimeve për të mundur zbatimin e detyrimeve ligjore, por jo vetëm, duke synuar kështu ushtrimin hap mbas hapi të një qeverisje dixhitale nga ana e Këshillit. Ky transformim i madh është në funksion të qeverisjes së mirë dhe në përgjigje të kërkesave dhe nevojave të qytetarëve digjitalë të cilët kërkojnë nga këshillat shërbime dhe ndërveprime digjitale në kohë reale. Vullneti politik i Këshilli është faktor kyç në këtë proces transformimi.

Qeveritë në përgjithësi dhe bashkitë në veçanti, në botë, po avancojnë shpejtë drejtë modelit të qeverisë digjitale. Studimet e OECD për vlerësimin e qeverisjes digjitale të shteteve të ndryshme në kuadër të transformimit digjital të sektorit publik, vënë në dukje se “teknologjitë digjitale po ndryshojnë radikalisht mënyrën sesi qytetarët jetojnë, punojnë, kërkojnë shërbime dhe ndërveprojnë”, si dhe nevojën për “zhvillimin e aftësive digjitale dhe rritjen e ndërgjegjësimit të drejtuesve, vendimmarrësve dhe zbatuesve të politikave publike për sfidat dhe mundësitë për transformimin digjital”.⁷

⁵ e-Qeverisja, Anketimi 2020, Banka Boterore.

⁶ OECD, Korniza e politikave të qeverisë dixhitale: Gjashtë dimensionet e një qeverie dixhitale (2020), (OECD Digital Government Policy Framework: Six dimensions of a Digital Government)


⁷ https://read.oecd-ilibrary.org/governance/digital-government-review-of-brazil_9789264307636-en#page13

Qeveria digjitale është përdorimi i teknologjive dixhitale, si një pjesë e integruar e strategjive të modernizimit të qeverive, për të krijuar vlerë të shtuar publike (OECD, 2014)⁸, dhe ku qytetarët janë pjesëmarrës aktiv në dizejnimin e proceseve dhe përmbajtjes së politikave e shërbimeve publike vendore, pra ata janë fokusi dhe shtysa.

Ndërkohë, e-Qeveria është përdorimi i teknologjisë dhe të dhënave për të transformuar operacionet e brendshme, dhënjen e informacionit, ofrimin e shërbimeve dhe mekanizmat ndërveprues me publikun, duke shërbyer kështu si një platformë e qeverisë digjitale, pasi aplikon teknologjinë për të mbështetur funksionet e qeverisë. Në rastin e e-Qeverisë qytetarët janë përfitues të shërbimeve dhe teknologjia është në fokus.

Vizioni i këshillave bashkiak duhet të jetë drejt mundësisimit të Qeverisje e Zgjuar (SMART), e cila, bazuar në analizën e sasive të mëdha të të dhënave, siguron që të gjitha aspektet e administrimit të qeverisjes trajtohen në mënyrë efikase dhe efektive, dhe janë të koordinuara brenda një sistemi qeverisës e administrativ plotësisht të integruar dhe elektronik, dhe ku shoqëria është fokus. Qeverisja digjitale e Këshillit mundëson ndëkohe edhe e-Demokracinë vendore, duke i dhënë mundësinë qytetarëve dhe palëve interesuara të angazhohen direkt në vendimarrjen vendore duke përdorur platformat dhe mjetet digjitale të vëna në dispozicion nga Këshilli apo jo.


Komponentet e E-DEMOKRACISE



Elementë kyç të qeverisjes dixhitale janë e-Transparenca, e-Pjesëmarrja, e-Sherbimet dhe e-Llogaridhënja. Këshillat duhet të mundësojnë përdorimin e këtyre elementëve si platforma që ulin kostot dhe rrisin cilësinë e qeverisjes dhe të ndërveprimit me qytetarët.

⁸ OECD, Recommendation of the Council on Digital Government Strategies, (2014)

Aktoret, kontributet, rezultatet e E-PJESEMARRJES



Qeverisja digjitale e këshillit do t'i fuqizonte qytetarët të përfshiheshin në mënyrë aktive, të shpejtë e dinamike në bashkëqeverisjes vendore. Këshillat duhet të eksplorojnë dhe promovojnë metoda, teknologji dhe mënyra inovatore për të nxitur dhe mbështetur angazhimin digjital të qytetarëve në qeverisjen vendore, dhe për të mundësuar procese pjesëmarrëse cilësore dhe efektive, të hapura, të aksesueshme nga të gjithë, në përgjigje të vazhdueshmë të avancimit të teknologjive të informacionit dhe njohurive dhe aftësive digjitale të qytetarëve. KOHA ESHTË TANI!


KOMPONENTË E QEVERISJES DIGJITALE

Faqja zyrtare të internetit e këshillit është portali elektronik për bërjen publike të njoftimeve, projekakteve, akteve, vendimmarrjes dhe procesit vendimmarrës, veprimtarisë dhe dokumentacionit të Këshillit, si dhe për kryerjen e procesit të informimit dhe këshillimit publik. Aktivitetet e Këshillit, të komisioneve të Këshillit dhe të këshilltarëve pasqyrohen në faqen e internetit të Bashkisë, në një ndërfaqe të veçantë, dhe në median sociale zyrtare të këshillit.

Këshillat duhet të përgatiten për të përdorur të Dhënave të Hapura si rregull, për të bërë transparente veprimtarinë, vendimmarrjen dhe dokumentacionin e tyre,⁹ pasi të dhënat që zhvillojnë dhe mbajnë këshillat janë aset për shoqërinë, qeverinë bashkiake, qytetarët dhe bizneset.

⁹ Projekt Ligji i vitit 2020 “Për të Dhënat e Hapura dhe Ripërdorimin e Informacionit të Sektorit Publik”

Konteksti në të cilin operon këshillit digjital



e-Transparenca

Këshilli bashkiak ka detyrimin ligjor t’i garantojë publikut transparencën e veprimtarisë së tij, të politikëbërjes dhe vendimmarrjes, si dhe të mundësojë mbledhje transparente dhe të hapura.¹⁰

Rregulloja e këshillit kërkon që mbledhjet dhe dëgjuesat publike të Këshillit të transmetohen direkt në faqen zyrtare të internetit të bashkisë si dhe në sèpaku në një nga mediat audiovizive vendore me transmetim në të gjithë territorin e bashkisë, si dhe transmetimin direkt në faqen zyrtare të internetit të bashkisë të mbledhjeve të hapura dhe dëgjësave publike të komisioneve të këshillit. Gjithashtu këshilli u mundëson qytetarëve qasje në arkivin e videove të mbledhjeve të këshillit dhe të komisioneve të tij, nga faqja e internetit zyrtare e bashkisë.¹¹

Këshilli bashkiak ka detyrimin ligjor të publikojë në faqen zyrtare të internetit të bashkisë çdo akt të nxjerrë nga këshilli bashkiak,¹² si dhe çdo projektakt që i paraqitet Këshilli për shqyrtim, sipas kërkesave të ligjit nr 146/2014. Këto detyrime secili këshill i realizon në bashkëpunim dhe me mbështetjen e administratës së bashkisë përkatëse, dhe specifikisht me mbështetjen e koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik, drejtuesit e drejtorive/sectorëve, si dhe punonjësit e drejtorisë/ sektorit TIK të bashkisë.

Përsa i përket akteve të këshillit, kopja e parë origjinale e çdo vendimi të këshillit skanohet dhe arkivohet në formatin pdf për t’u bërë publike në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë.¹³ Për aktet që përmbajnë rregulla, norma apo kufizime të të drejtave dhe lirive themelore të individit, si dhe ato me efekt të drejtpërdrejtë për qytetarët, Këshilli i bën ato publike edhe në faqen zyrtare të internetit, brenda 48 orëve prej miratimit të aktit nga këshilli bashkiak.¹⁴

Ndërkohë këshilli bashkiak garanton krijimin dhe arkivimin e një kopje digjitale të faqes zyrtare të internetit të bashkisë, dhe veçanërisht të ndërfaqes së internetit të këshillit bashkiak, e plotësuar kjo me

¹⁰ Neni 17/1 i Ligjit nr. 139/2015.

¹¹ Rregullorja e brendshme e këshillit bashkiak

¹² Neni 15 i Ligjit nr. 139/2015.

¹³ Rregullorja e brendshme e këshillit bashkiak


¹⁴ Neni 7, pika 3 e Ligjit nr. 119/2014.

informacionin që kërkohet sipas programit të transparencës të miratura nga Këshilli, si dhe përcakton metodat, mekanizmat dhe periodicitetin e publikimit të informacioneve publike, të cilat vihen në dispozicion të publikut pa kërkesë.¹⁵ Ky detyrim ligjor kërkon që çdo këshill bashkiak të garantojë krijimin, publikimin, popullimin, mirëmbajtjen dhe ruajtjen e informacionit të faqes së internetit të bashkisë, dhe veçanërisht të ndërfaqes së vetë këshillit bashkiak.

Këshilli, gjithashtu, mundëson publikimin në faqen e internetit të programit të transparencës, si dhe të planeve vjetore të këshillit për procesin e vendimmarrjes.¹⁶

Këshilli, në përputhje me programin e transparencës së miratuar, përgatit paraprakisht, në formate lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme, si dhe vënë në dispozicion të publikut në faqen e internetit të bashkisë, kategoritë e informacionit të cituara në Ligjin nr. 119/2014,¹⁷ si dhe ato të cituara në urdhërin e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.¹⁸

Komponentet e E-TRANSPARENÇES



Faqja e internetit e këshillit mundëson edhe zbatimin e parimeve për garantimin e të drejtës së informimit, si:¹⁹

- Vendosja në dispozicion të çdo qytetari, të gjithë informacionit të prodhuar nga veprimtaria e këshillit.
- Ligjshmëria, transparenca dhe të mos diskriminimi në ofrimin e informacionit.
- Ofrimi i informacionit pa pagesë. Informacioni i kërkuar në rrugë elektronike i jepet çdo qytetari pa pagesë.
- Aksesit për këdo. Aksesit për shtresat më të varfra të komunitetit, qytetarët me aftësi të kufizuara, gratë, të rinjtë, biznesin, fermerët, qytetarët e zonave të largëta etj, merr përparësi.
- Thjeshtëzimi i procedurave administrative për aksesin në informacion.
- Dhënia e informacionit sa më shpejtë që të jetë e mundur.

¹⁵ Neni 7, pika 2 e Ligjit nr. 119/2014.

¹⁶ Neni 6/b i Ligjit 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin public.

¹⁷ Neni 2 dhe neni 7 i Ligji nr. 119/2014.

¹⁸ Urdhëri i Komisionerit për të Drejtën e Informimit, nr. 213 dt. 10.09.2018 “Për programin e transparencës për NJQV”.

¹⁹ idem

- Cilësia e informacionit

Në përgatitje e programit e tij të transparencës për publikim në faqen e internetit, këshilli i referohet 7 fushave,²⁰ (shih shtojcesn nr. 1 të këtij udhëzimi).

Këshilli publikon gjithashtu, përmes faqen zyrtare të internetit, regjistrin elektronik të projektakteve, përfshirë njoftimet për konsultim, si dhe të dhëna të lidhura me konsultimin e projektakteve.²¹ Regjistri elektronik i projektakteve është faqja zyrtare e internetit ku do të publikohen projektaktet²² që depozitohen zyrtarisht pranë Këshillit për shqyrtim dhe vendimmarrje.

Këshilli krijon, mban dhe bën publik një regjistër të posaçëm, ku pasqyrohen të gjitha kërkesat për informim dhe informacionet e dhëna në përgjigje të tyre. Ky regjistër përditësohet çdo 3 muaj dhe publikohet në faqen e internetit të Bashkisë.²³

Këshilli gjithashtu krijon, mban dhe bën publik në faqen e internetit regjistrin ku pasqyrohen të gjitha ankesat dhe kërkesat drejtuar Këshillit, regjistrin për transparencën e mbledhjeve të këshillit, si dhe regjistrin e peticioneve dhe iniciativave qytetare. Detyrimi për publikimin dhe elementët e formatit të këtyre regjistrave janë sipas “Rregullores së këshillit për marrëdhënjet me publikun”.

Një regjistër tjetër që Këshilli ka detyrimin ta publikojë në faqen e internetit është edhe ai deklaratave rast pas rasti të konfliktit të interesit të këshilltarëve.²⁴ Regjistrimi i konfliktit të interesave kryhet në çdo rast të shfaqjes së konfliktit nga veprimtaria e Këshilltarit, në çdo fazë të procesit përgatitjes dhe të vendimmarrjes për një projektakt të caktuar që përgatitet apo shqyrtohet nga këshilli.

Sekretari i këshillit është përgjegjës për pasqyrimin e aktiviteteve të Këshillit, komisioneve të Këshillit dhe këshilltarëve, në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë.²⁵

e-Pjesëmarrja dhe e-Konsultimet

Pjesëmarrja është një dimension kryesor i qeverisjes dhe një nga shtyllat e zhvillimit të qëndrueshëm.²⁶ Pjesëmarrja e publikut në procesin e politikëbërjes dhe vendimmarrjes së Këshillit, nxitet nëpërmjet faqes së internetit dhe rrjeteve sociale zyrtare të bashkisë. Ndërkohë që mjetet tradicionale të e-pjesëmarrjes, si e-konsultimet, e-ankesat, e-sondazhet, e-forume, e-peticionet, e-dhomat e bisedave (chat rooms), e-blogjet, etj, janë në dispozicion të këshillave për proceset e tyre qeverisëse, edhe rrjetet e mediave sociale, si Facebook, Twitter, YouTube, Instagram etj, mbeten një mundësi për tu përdorur nga këshillat për të mundësuar dhe nxitur e-pjesëmarrjen.

Publiku mund të përdorë gjithashtu postën elektronike zyrtare të këshillit për të komunikuar me organet e këshillin, si dhe postën elektronike zyrtare të këshilltarëve, të publikuar në ndërfaqen zyrtare të internetit, për të ndërvepruar me këshilltarët.

Këshilli Bashkiak organizon një herë vit një pyetesor elektronik, për prioritetet e buxhetit, si dhe një pyetesor elektronik për çdo projekt dokument të një strategjie apo të një planit të shërbimit publik.

²⁰ idem

²¹ Neni 6/a i Ligjit 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”

²² Neni 2/12 i Ligjit 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”

²³ Neni 8, i Ligjit nr. 119/2014 “Mbi të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”


²⁴ Neni 52 i Ligjit nr. 139/2015; Neni 11 i Ligji nr. 9367/2005; Rregullorja e brendshme e KB).

²⁵ Rregullorja e këshillit për komunikimin me publikun dhe median.

²⁶ e-Qeverisja, Anketimi 2020, Banka Boterore.

Pyetësori mundëson futjen e të dhënave të përkatësisë gjinore të plotësuesit të pyetësorit dhe raportet e pyetësorëve publikohet në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë.²⁷

Komponentet e E-PJESEMARRJES



Përveç sa më sipër, Këshilli është i detyruara të marrë të gjitha masat e nevojshme, në mënyrë që të krijojë mundësi për pjesëmarrjen e publikut në procesin e njoftimit e të konsultimit publik elektronik, përmes publikimit në faqen zyrtare te internetit, të regjistrimit elektronik të projektakteve, përfshirë njoftimet për konsultim, si dhe të dhënave të lidhura me konsultimin e projektakteve, si dhe dhënien e informacionit elektronik në lidhje me procesin e njoftimit dhe të konsultimit publik në të gjitha fazat, duke filluar nga publikimi i projektaktit, marrja e komenteve dhe rekomandimeve për përmirësimin e tij, organizimi i debateve publike e deri te miratimi i aktit përfundimtar.²⁸ Çdo projektakt²⁹ publikohet në regjistrin elektronik për njoftimin dhe konsultimin publik. 10.

Regjistri Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike përmban në bazën e tij të të dhënave: a) të gjitha projektdokumentet strategjike, kombëtare dhe vendore, si dhe të politikave me interes të lartë publik; b) të gjitha projektaktet, njoftimet për konsultim dhe të dhënat e lidhura me konsultimin e projektakteve; c) planet vjetore të organeve publike që lidhen me procesin e vendimmarrjes, në kuptim të ligjit nr. 146/2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik”; ç) informacionin në lidhje me procesin e njoftimit dhe të konsultimit publik në të gjitha fazat, duke filluar nga publikimi i projektaktit, marrja e komenteve dhe rekomandimeve për përmirësimin e tij, organizimi i debateve publike e deri te miratimi i aktit përfundimtar. Të gjitha projektaktet në faqen web duhet të jenë të plota. Çdo projektakt duhet të publikohet si një dosje/file e veçantë në format elektronik të përshtatshëm, për t’u ruajtur, shkarkuar dhe ripërdorur sipas rregullores së miratuar nga AKSHI për të dhëna të hapura.³⁰

²⁷ Idem.

²⁸ Neni 6 i Ligjit 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”

²⁹ Projektakt- projekti i një ligji vendor, projekte të dokumenteve strategjike vendore, të politikave me interes të lartë publik, të hartuara nga bashkia, si dhe sipas kërkesave të nenit 18/1 të Ligjit nr. 139/2015.

³⁰ VKM nr. 828, datë 7.10.2015 “Për miratimin e rregullave të krijimit dhe administrimit të regjistrimit elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike”.

Këshilli përpara shqyrtimit dhe miratimit të projektakteve, zhvillon seanca këshillimi me bashkësinë të informuar paraprakisht nga platforma elektronike e konsultimeve publike, në raste kur këshilli.³¹

- a. zgjedh nga përbërja e vet komisionet e Këshillit dhe miraton rregulloren e brendshme të funksionimit të vet;
- b. miraton buxhetin dhe ndryshimet e tij, si dhe numrin e maksimal të punonjësve të bashkisë dhe të njësive e institucioneve buxhetore në varësi të bashkisë;
- c. miraton tjetërsimin ose dhënien në përdorim të pronave të tretëve;
- d. miraton politikën fiskale të Bashkisë dhe vendos për taksat e tarifat vendore;
- e. miraton norma, standarde e kritere për rregullimin dhe disiplinimin e funksioneve që i janë dhënë atij me ligj;
- f. miraton norma, standarde e kritere për mbrojtjen e garantimin e interesit publik,
- g. merr kredi.

Takimet e këshillimeve publike për çështje të rëndësishme, transmetohen në median audiovizive publike, si dhe në faqen e internetit zyrtare të Këshillit, ndërkohë, procesverbalet e takimeve publike të organizuara nga këshilli janë dokumente zyrtare, dhe publikohen në faqen e internetit të bashkisë.³²

Këshilli ndërkohë, garanton ngritjen e sistemit për regjistrimin e komenteve dhe rekomandimeve elektronike të bashkësisë, të dërguara përmes platformës elektronike të konsultimeve publike, si dhe dërgimin e përgjigjeve për rekomandimet e pranuar dhe arsyet e mospranimit të rekomandimeve. Ai gjithashtu garanton ngritjen e sistemit elektronik për marrjen e ankesave për mos zbatimin e detyrimeve të ligjit dhe rregullores së e këshillit për komunikimin me publikun dhe median, në lidhje me njoftimin dhe këshillimin publik me bashkësinë.³³

Marrja, shqyrtimi, analizimi dhe publikimi i ankesave të qytetarëve drejtuar këshillit janë një mjet shumë efektiv për të nxitur pjesëmarrjen e qytetarëve në qeverisjen vendore dhe për të ndërtuar urat e besimit me qytetarët. Këshilli mundëson ndërtimin e një sistem elektronik për informimin, marrjen dhe regjistrimin e ankesave dhe përgjigjeve, nëpërmjet faqës së internetit zyrtare të Bashkisë.³⁴

e-Peticionet dhe mundësimi i nënshkrimeve në mënyrë elektronike i tyre, përmes faqes së internetit të Bashkisë, është një detyrim që i vjen Këshillit nga rregullorja,³⁵ dhe i mundëson qytetarëve qasje të menjëhershme dhe të mirëinformuar për të ndikuar axhendën vendimmarrëse të këshillit.

Për të vlerësuar mbarëvajtjen se procesit të këshillimit publik, Këshilli ndërmerr një anketim vjetor në formë elektronike, nëpërmjet faqes zyrtare të internetit, dhe raporti i këtij anketimi bëhet publik në faqen zyrtare të internetit.³⁶

e-Shërbimet

Një nga shërbimet që jep këshilli është edhe dhënja e informacionit sipas kërkesave që i drejtohen këshillit në lidhje me informacionet dhe dokumentet që disponon këshilli. Këshilli krijon, mban dhe bën publik një regjistër të posaçëm, ku pasqyrohen të gjitha kërkesat për informim dhe informacionet

³¹ Neni 18/1 i Ligjit nr. 139/2015, Rregullorja e brendshme e këshillit

³² Neni 6/2/ i Ligjit nr. 146/2014; Rregullorja e këshillit për komunikimin me publikun dhe median.

³³ Rregullorja e këshillit për komunikimin me publikun dhe median

³⁴ Idem.

³⁵ Rregullorja e këshillit për komunikimin me publikun dhe median.

³⁶ Idem.

e dhëna në përgjigje të tyre. Ky regjistër përditësohet çdo 3 muaj dhe publikohet në ndërfaqen e internetit të këshillit.³⁷

e-Llogaridhënja

Si një nga përgjegjësitë kryesore të këshillit, llogaridhënja i mundëson këshillit ti paraqesë publikut rezultatet e qeverisjes. e-Llogaridhënja mundwson prezantimin në faqen e internetit të raporteve të performancës për zbatimin e politikave, planeve, detyrimeve ligjore, si dhe mundëson komente dhe reagime në khë reale dhe dinamike nga publikut ndaj performancës së këshillit.

Për të mundësuar një llogaridhënje efektive, këshilli harton dhe publikon në faqen e internetit, por jo vetëm:

- Planin vjetor i procesit të vendimmarrjes
- Raportin vjetor për transparencën e procesit të vendimmarrjes, ku përfshihet informacion për: a) numrin e akteve të miratuara nga këshilli gjatë vitit referues; b) numrin e rekomandimeve të marra nga palët e interesuara për projektaktet e bëra publike për konsultim; c) numrin e rekomandimeve të komenteve të pranuar dhe të refuzuara gjatë procesit të vendimmarrjes; d) numrin e takimeve publike të organizuara.³⁸
- Strukturën e raportit të zbatimit të buxhetit të Bashkisë dhe strukturën e raportit të zbatimit të buxhetit për publikun “Raporti i Zbatimit të Buxhetit për Qytetarin”.
- Raporti Vjetor i Punës së Këshillit
- Raporti Vjetor i Zbatimit të Buxhetit të Këshillit
- Raporti i Pjesëmarrjes së Këshilltarëve në Punët e Këshillit
- Raportet e Auditimit të Këshillit
- Raporte të Monitorimit të Performancës së Veprimtarisë së Këshillit, nga ojf-të apo tjetër.

QEVERSIJA E KESHILLIT PER ZHVILLIMIN E KESHILLIT DIGJITAL

Transformimi në “këshill bashkiak digjital” kërkon një mirëqeverisje të procesit të transformimit, përfshirë burime njerëzore me kapacitete, kalimin në shërbime elektronike, identifikimin dhe përdorimin e teknologjive TIK, si dhe krijimin dhe qeverisjen e të dhënave digjitale.

Ky transformim nga “këshill tradicional” në një “këshill digjital”, kërkon bërjen e disa ndryshimeve të integruara në punët dhe ndërveprimin e këshillit, si: ndryshimi i mendësisë së qeverisjes që fokuson qytetarin digjital; një udhëheqje efektive nga drejtuesit e këshillit që mundëson vision dhe strategji të transformit digjital, kërkon një transformim organizativ të këshillit për t’ju përshtatur nevojave të qytetarëve si dhe këshillit; transformimin e menaxhimit të punëve dhe alokimit të fondeve për të ndërtuar dhe përdorur sisteme digjitale pune; transformimin dhe bashkohësinë e teknologjisë TIK që përdor këshilli; si dhe krijimin, manaxhimin, ruajtjen dhe publikimin e të dhënave digjitale të hapura.

Në përpjekjen e tij për zhvillimin e një ndërveprimi digjital me qytetarët por edhe për digjitalizimin e punëve të Këshillit, drejtuesit e Këshillit duhet iniciojnë **miratimin e kornizës strategjike për digjitalizimin e Këshillit**. Kjo nënkupton miratimin e një vizioni dhe të strategjisë për digjitalizimin e Këshillit. Kjo përpjekje duhet pasuar me hartimin dhe miratimin e Planit për faqen e internetit të KB, Planin për komunikimin digjital të KB, Planin për median sociale të KB, Politikën e angazhimit

³⁷ Neni 8 i Ligjit nr. 119/2014 “Mbi të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”.

³⁸ Neni 20 i Ligjit nr. 146/2014.

digjital të publikut me KB, si dhe Planin për promovimin e këshillit digjital. Të menduarit strategjik si dhe të menduarit në sistem dhe integrim të sistemeve elektronike në nivel bashkie, kërkon nga drejtuesit e këshillit një qasje të integruara për politikëbërjen në ofrimin e shërbimeve elektronike në kuadër të bashkisë digjitale.

Në lidhje me “Politikën e angazhimit digjital të publikut”, Këshilli duhet të përcaktojë qëllimin, parimet, përkufizimet, përgjegjësitë e Këshillit dhe të administratës në transformimin digjital të Këshillit, rastet kur do të përdoret angazhimi publik digjital, qasjet e ndryshme për angazhimin digjital të publik, dhe rezultatet e zbatimi të kësaj politike. Në kuadër të Politikës, Këshilli duhet të miratojë “Kornizën e Angazhimit Digjital të Publikut”, me komponentë si:

- Procedurat administrative që duhet të ndjekë administrata për zbatimin e Politikës.
- Qasjet e angazhimit publik digjital, mënyrat e ndryshme me të cilat publiku do të marrë pjesë në proceset e vendimmarrjes së këshillit.
- Procesi i planifikimit të angazhimit public, i cili të përcaktojë hapat që do të ndjekë këshilli, në mënyrë që aktivitetet e këshillit dhe administratës të jenë në përputhje me Politikën.
- Raportimi i angazhimit digjital të publikut, informimi i publikun për atë se çfarë ka dëgjuar këshilli nga publikun dhe çfarë vendimesh a marrë.
- Vlerësimi i angazhimit digjital të publikut, si përmirësimi i vazhdueshëm dhe mësimet e nxjerra nga planifikimi, aktivitetet dhe raportimi i angazhimit digjital të publikut.

Këshilli ndërkohë duhet të **zhvillojë një ekosistem institucional dhe kuadër rregullator** për ngritjen dhe menaxhimin e sistemit digjital të punëve dhe ndërveprimit të KB. Këshilli duhet të miratojë një kuadër rregullator për menaxhimin, mirëmbajtjen dhe ndërveprimin me ekzekutivin e bashkisë në lidhje procesin e digjitalizimit të KB, dhe veçanërisht në lidhje me ndërfaqen e internetit të KB. Në këtë kuadër Këshilli duhet të detajojë përgjegjësitë dhe detyrat e organeve të KB e të sekretariatit në lidhje me ndërfaqen e internetit, të plotësojë përshkrimet e punës së Sekretarit të KB dhe të punonjësve të sekretariatit në lidhje me ndërfaqen e internetit dhe ndërveprimin digjital të KB me qytetarët, ekzekutivin e bashkisë dhe agjencitë e tjera qeveritare. Këshilli duhet të miratojë rregulloren për mirëmbajtjen e përmbajtjes së ndërfaqes së internetit të KB dhe ruajtjes së të dhënave, si dhe të miratojë standartet për përmbajtjen e faqes së internetit të KB, të dhënave të hapura dhe sigurisë së të dhënave që zhvillohen dhe mirëmbahen nga KB. Në këtë kuadër Këshilli duhet të miratojë edhe Planin e prokurimit për ndërfaqen e internetit dhe infrastrukturën TIK për KB. Gjithashtu Këshilli duhet të garantojë miratimin e kontratave për zhvillimin, mirëmbajtjen dhe hostimin e ndërfaqes së internetit të KB.

Qeverisja e të dhënave, me fokus menaxhimin profesional të të dhënave digjitale, për të mundësuar politikëbërje të këshillit të drejtuar nga të dhënat, është një aspekt shumë i rëndësishëm i Këshillit digjital. Kjo kërkon krijimin e databazave me të dhënat që krijon dhe administron Këshilli dhe analiza periodike dhe profesionale të këtyre të dhënave, që do të mundësojë Këshillit një të kuptuar të shpejtë të sfidave, rreziqeve dhe mundësive, dhe vendimmarrje efektive dhe afër pritshmërive.

Zhvillimi i kapaciteteve dhe menaxhimi i punëve në lidhje me digjitalizimin e KB, dhe veçanërisht në lidhje me ndërfaqen e internetit të KB, duhet të shoqërojë në vazhdimësi procesin e digjitalizimit të KB. Këshilli duhet të garantojë dhe buxhetojë trajnime për fuqizimin e kapaciteteve të këshilltarëve dhe të Sekretariatit në lidhje me aspektet e digjitalizimit të punëve të KB, të faqes së internetit, si dhe të ndërveprimit digjital me komunitetin dhe palët e interesuara. Gjithashtu është e nevojshme që Këshilli të ngrejë një grup të përbashkët pune mes KB dhe drejtorisë TIK në bashki për të mbështetur

proçesin e digjitalizimit të punëve të KB. Nga ana tjetër, në mënyrë që kapacitetet digjitale që ngre KB, të jenë të përdorshme në mënyrë efektive nga qytetarët, Këshilli duhet të mundësojë fushata promovimi të ndërfaqes së internetit të KB. Zhvillimi i vazhdueshëm i kapaciteteve të komunitetit dhe i fushatave të edukimit për pëdorimin e uebfaqjes dhe ndërveprimin digjital me KB, me fokus mbërritjen sa më e gjërë tek komuniteti, për të mos lënë pas askënd.

Për të mundësuar transparencën, angazhimin dhe llogaridhënjen digjitale, këshilli duhet të garantojë menaxhimin dhe mirëmbajtjen e ndërfaqes së internetit të këshillit, nga akorët brenda dhe jashtë këshillit. Sekretari i Këshillit duhet të jetë përgjegjës për përmbajtjen, menaxhimin dhe mirëmbajtjen e të dhënave, privacinë e të dhënave, dhe këto detyra duhet të behën pjesë e përshkrimit të punës Sekretarit dhe punonjësive të tjerë të sekretariatit. Ndërkohë, drejtorja TIK e bashkisë duhet të shërbejë si uebmastër i ndërfaqes së internetit të këshillit, të trajtojë këshilltarët dhe stafin e Këshillit, ti ofrojë ndihmë Sekretariatit dhe punonjësive të tjerë të sekretariatit, të ofrojë mbështetjen teknike për operimin dhe sigurinë e ndërfaqes, të mirëmbajë infrastrukturën TIK, të mundësojë vazhdimësinë dhe përmirësimin e ndërfaqes së këshillit, dhe të dhënave.

Financimi i vazhdueshëm i transformimit digjital të KB është kyç për suksesin e procesit. Këshilli duhet të buxhetojë çdo vit zbatimin e strategjisë së digjitalizimit dhe planeve zbatuese të saj, të buxhetojë trajnimet, zhvillimin dhe mirëmbajtjen e ndërfaqes së internetit dhe të teknologjisë dhe infrastrukturës TIK. Këshilli duhet gjithashtu të vlerësojë mundësitë e mobilizimit të fondeve qeveritare dhe ndërkombëtare për e- qeverisjen, të shfrytëzojë kapacitetet teknike dhe databazat e agjencive qeveritare, p.sh të AKSHI-t, si dhe të vlerësojë mundësitë e angazhimit të sektorit privat në procesin zhvillimit dhe menaxhimi të procesit të digjitalizimit të KB.

Shtojca nr. 1 - Model program i transparencës së këshillit bashkiak

Programit i transparencës për publikim në ndërfaqen e internetit të këshilli i referohet fushave si më poshtë.³⁹

- **Fusha e parë:** Organizimi dhe funksionimi i këshillit bashkiak, statistikave në lidhje me këshillin, mekanizmat monitorues dhe të kontrollit ndaj këshilli, si dhe të drejtën e kërkesës, ankesës dhe vërejtjeve të qytetarëve që lidhen me veprimet ose mosveprimet e këshillit.
- **Fusha e dytë:** Transparenca dhe llogaridhënia ekonomiko-financiare.
- **Fusha e tretë:** Kërkesat për informim, përfshin vendosjen në dispozicion të qytetarëve të informacionit që ka të bëjë me procesin, procedurat, format dhe afatet e kërkesës për informim.
- **Fusha e katërt:** Mbi shërbimet që ofron, përfshin informacion mbi shërbimet që ofron bashkia të përcaktuara në nenin 7 (pika: f, j, ë dhe pjesërisht pika a) të ligjit nr. 119/2014.
- **Fusha e pestë:** Legjislacioni dhe aktet e brendshme rregullatore, u ofron qytetarëve informacion për legjislacionin, politikën, vendimet, urdhëresat dhe urdhrat karakter normativ të miratuara nga këshilli.
- **Fusha e gjashtë:** Pjesëmarrja qytetare në vendimmarrje, përfshin informacion në lidhje me procesin, procedurat, kuadrin rregullator vendor, listën e akteve vendore që i nënshtrohen konsultimit publik dhe nismat qytetare.
- **Fusha e shtatë:** Informacion si proceset e integritetit evropian (programet dhe projektet); shoqëria civile; raporte, studime dhe vlerësime të ndryshme, p.sh vlerësimin e transparencës etj; vet-organizimi komunitar etj.

Kategoritë e informacionit që këshilli bën publik pa kërkesë, në faqen e internetit, janë:⁴⁰

- a) strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave të Këshillit;
- b) tekstet e plota:
 - iii) të akteve nënligjore;
 - iv) të kodeve të sjelljes;
 - v) të çdo dokumenti politikash;
 - vi) të manualit ose ndonjë dokument tjetër që ka lidhje me ushtrimin;
- c) procedurat për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës;
- ç) të dhëna për vendndodhjen e zyrave të këshillit, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit;
- d) të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë, sipas ligjit, strukturat e pagave për nëpunësit e tjerë, si dhe një përshkrim të procedurave të zgjedhjes, kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të këshillit dhe procedurën që ata ndjekin për të marrë vendime;
- dh) mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi këshillin, përfshirë planet strategjike të punës, raportet e auditimit nga KLSH ose subjekte të tjera, dokumentet që përmbajnë tregues të performancës së këshillit;
- e) të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit të bashkisë dhe këshillit.

³⁹ idem

⁴⁰ Neni 7 i Ligjit nr. 119/2014. Urdhëri i Komisionerit për të Drejtën e Informimit, nr. 213 dt. 10.09.2018 “Për programin e transparencës për NJQV”.

ë) informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat, duke përfshirë:

- i) listën e kontratave të lidhura;
- ii) shumat e kontraktuara;
- iii) palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara;
- iv) informacionin për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme;
- f) informacion për shërbimet që këshilli i jep publikut, përfshirë standardet për cilësinë e shërbimit;

g) çdo mekanizëm dhe procedurë për bërjen e kërkesave dhe ankesave;

gj) çdo mekanizëm apo procedurë, përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të këshillit;

h) një përshkrim të thjeshtë të sistemit që përdor këshilli për mbajtjen e dokumentacionit.

Këshilli publikon gjithashtu, përmes faqen zyrtare të internetit:

1. Regjistrin e Akteve/Vendimeve të Këshillit (Ligji nr. 139/2015, neni 15/3; kundërshtimet nga Prefekti dhe në gjykatë).
2. Regjistrin për Njoftimin dhe Këshillimin Publik të Projektakteve (Ligji 146/2014, neni 7). Regjistri elektronik i projektakteve është faqja zyrtare e internetit ku do të publikohen projektaktet⁴¹ që depozitohen zyrtarisht pranë Këshillit për shqyrtim dhe vendimmarrje, si dhe të dhënave të lidhura me konsultimin e projektakteve.⁴²
3. Regjistrin për Transparencën e Mbledhjeve të KB (Ligji nr. 139/2015, neni 15, Rregullorja për Marredhenjet me Publikun)
4. Regjistrin e Kërkesave për Informacion drejtuar Këshillit (Ligji 119/2014, neni 8). Në këtë regjistër pasqyrohen të gjitha kërkesat për informim dhe informacionet e dhëna në përgjigje të tyre. Ky regjistër përditësohet çdo 3 muaj dhe publikohet në faqen e internetit të Bashkisë.⁴³ Regjistrin e Ankesave dhe Kërkesave drejtuar Këshillit (Rregullorja e KB për Marredhenjet me Publikun)
5. Regjistrin e Peticioneve dhe Iniciativave Qytetare (Rregullorja e KB për Peticionet dhe Iniciativat Qytetare)
6. Regjistrin e Deklaratave të Konfliktit të Interesit të Këshilltarëve (Ligji nr. 139/2015; Ligji nr. 9367/2005; Rregullorja e KB). Regjistri i deklaratave rast pas rasti të konfliktit të interesit të këshilltarëve⁴⁴ bazohet në regjistrimin e konfliktit të interesave në çdo rast të shfaqjes së konfliktit nga veprimtaria e Këshilltarit, në çdo fazë të procesit përgatitjes dhe të vendimmarrjes për një projektakt të caktuar që përgatitet apo shqyrtohet nga këshilli.
7. Regjistrin e Pjesëmarrjes së Publikut në Dëgjuesat e Takimet Publike, të dhëna gjinore (Ligji nr. 9970/2008, Rregullorja e KB)
8. Regjistrin e Anëtarëve të Bordeve dhe Komiteteve të ngritura nga Këshilli, me të dhëna gjinore (Rregullorja e KB)

⁴¹ Neni 2/12 i Ligjit 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”

⁴² Neni 6/a i Ligjit 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”

⁴³ Neni 8, i Ligjit nr. 119/2014 “Mbi te drejten e informimit per dokumentet zyrtare”

⁴⁴ Neni 52 i Ligjit nr. 139/2015; Neni 11 i Ligji nr. 9367/2005; Rregullorja e brëndshme e KB).

9. Regjistrin e Lobimeve dhe Lobuesve (Rregullorja e KB)
10. Regjistrin e Dhuratave, Përfitimeve nga Këshilltarët
11. Regjistrin e Donacioneve dhe Granteve të bëra nga Këshilli
12. Regjistrin e Delegimeve nga Drejtuesit e Organeve të Këshillit

Sekretari i këshillit është përgjegjës për pasqyrimin e aktiviteteve të Këshillit, komisioneve të Këshillit dhe këshilltarëve, në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë.⁴⁵, si dhe mirembajtjen e te dhenave te regjistrave.

Kategoritë e informacionit që këshilli bën publik pa kërkesë, në faqen e ininternetit, janë:⁴⁶

- a) strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave e Këshillit;
- b) tekstet e plota:
 - iii) të akteve nënligjore;
 - iv) të kodeve të sjelljes;
 - v) të çdo dokumenti politikash;
 - vi) të manualit ose ndonjë dokument tjetër që ka lidhje me ushtrimin;
- c) procedurat për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës;
- ç) të dhëna për vendndodhjen e zyrave të këshillit, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit;
- d) të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë, sipas ligjit, strukturat e pagave për nëpunësit e tjerë, si dhe një përshkrim të procedurave të zgjedhjes, kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të këshillit dhe procedurën që ata ndjekin për të marrë vendime;
- dh) mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi këshillin, përfshirë planet strategjike të punës, raportet e auditimit nga KLSH ose subjekte të tjera, dokumentet që përmbajnë tregues të performancës së këshillit;
- e) të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit të bashkisë dhe këshillit.
- ë) informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat, duke përfshirë:
 - i) listën e kontratave të lidhura;
 - ii) shumat e kontraktuara;
 - iii) palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara;
 - iv) informacionin për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme;
 - f) informacion për shërbimet që këshilli i jep publikut, përfshirë standardet për cilësinë e shërbimit;
- g) çdo mekanizëm dhe procedurë për bërjen e kërkesave dhe ankesave;


⁴⁵ “Rregullorja e Brendshme e Këshillit”, si dhe “Rregullorja e Këshillit për Komunikimin me Publikun dhe Median”

⁴⁶ Neni 7 i Ligjit nr. 119/2014. Urdhëri i Komisionerit për të Drejtën e Informimit, nr. 213 dt. 10.09.2018 “Për programin e transparencës për NJQV”.

gj) çdo mekanizëm apo procedurë, përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të këshillit;

h) një përshkrim të thjeshtë të sistemit që përdor këshilli për mbajtjen e dokumentacionit.

Struktura Bazë e Pëmbajtjes së Ndërfaqes së Interneti të Këshillit



Shtojca nr. 2 - Elementët kyç të programit elektronik të transparencës së këshillit bashkiak

TRAJNIM RAJONAL "E-KËSHILLI NË PARTNERITET ME QYTETARËT", Prill- Korrik 2021		
BASHKIA _____		
ELEMENTET E PERMBAJTTJES KYCE TE PROGRAMIT ELEKTRONIK TE TRANSPARENCES SE KESHILLIT		
Nr.	KATEGORIA	ELEMENTET
	N/kategoria	
I.	KESHILLI, KESHILLTARET	
	Ligjislacion kyç	Ligji nr. 8417/1998, Ligjinr. 8548/2000, Ligji nr. 139/2015, Ligji nr. 8480/1999, Ligji nr. 115/2014, Ligji nr. 68/2017, Ligji 119/2014, Ligji nr. 146/2014, Ligji nr. 9887/2008, Ligji nr. 9367/2005, Ligji nr. 44/2015 KPA, Ligji nr. 9131/2003, Funksionet e Këshillit, Rregullorja e brendshme, Rregullorja e konsultimeve publike, Rregullorja e ankesave, peticioneve, iniciativave qytetare, Rregullorja e strukturave komunitare, Rregullorja për Kodin e Etikës, Rregullorja për konfliktin e interesit, Etj.
	Kush jemi ne	
1		Anetaret (foto, emri, CV, pozicioni, perkatesia politike ose jo, komisioni ku eshte anetar, kontaktet, etj)
2		Komisionet (emertesa, perberja, funksionet, kryetari, kontaktet, etj)
3		Konferenca e kryetarëve (emrat, perkatesia, funksionet, detyrat)
4		Sekretari, punonjesit e sekretariatit (emri, CV, gjinia, kontaktet)
5		Te dhenat e zgjedhjeve vendore

Puna e Keshillit dhe Keshilltareve		
1		Plani vjetor i vendimmartjes
2		Kalendari i mbledhjeve te Keshillit per cdo muaj
3		Kalendari i mbledhjeve te komisioneve per cdo muaj
4		Paketa e mbledhjes se Keshillit me link per shkarkimin e doc-s: njoftimi, axhenda, relacionet, dokumentete, videoteka, procesverbalet)
5		Paketa e mbledhjes se komisionve me link per shkarkimin e doc-s: njoftimi, axhenda, relacionet, dokumentete, videoteka, procesverbalet)
Vendimmarrja e Keshillit		
1		Vendimet/Aktet (pefshire perputhshmerine e prefektit) me 4-5 filtra kerkimi
2		Rregjistri i projekt akteve per konsultim publik
3		Regjistri i akteve te KB sipas viteve (linku per shkarkim, pdf)
Transparenca		
1		Programi i Transparences se KB
2		Pagesat dhe shperblimet e keshilltareve

3		Anetaresimet e KB në organizata dhe shoqata
4		Rregjistri i konfliktit të interesit të keshilltareve (link)
5		Ndryshimet e buxhetit (sipas propozuesit, programit buxhetor, dates se mbledhjes ku është miratuar)
6		Donacionet dhene KB
7		Anetaresimet e KB
Partneritete, Projekte		
1		Projekte të KB, përfshirë ato me partnere
2		Projektet dhe veprimtari të KB në kuadrin e integritimit në BE
3		Nismat advokuese, lobuese dhe monitoruese nga SHC, ndaj KB
Publikimet		
1		Botime të KB, si dokumente politikash (strategji, plane, etj)
2		Gazeta zyrtare e KB
3		Permbledhje statistikore
Sherbimet për keshilltarët		
1		Plani dy vjeçar i trajnimeve për keshilltarët

2		Kalendari i trajnimeve per keshilltaret
3		Modulet e trajnimit (permbledhje)
4		Lidhje per e-mesimnxenje te keshilltareve
5		Webinars per trajnimin e keshilltaret
	Ngjarjet, Aktivitetet	
1		Kalendari i ngjarjeve te KB
2		Ceremonit e KB
II.	QYTETARI, BIZNESI	
	Sherbimet per qytetaret, bizneset	
1		Regjistri i kerkesat per informacion derguar KB (lidhja per shkarkim)
2		Formatet, procedurat, afatet, tarifat per kerkesat per informim
3		Rasteve të kufizimit të së drejtës për informim
4		Subjekteve që përfitojnë informacionin falas
5		Informacioneve të kërkuara më shpesh nga publiku
6		e-Sherbime te KB
7		Dorezimi i kerkeses. Log-in sipas grup-moshes, gjinise, territorit, ceshtjes, statusit (qytetar, biznes, OJF, akademi)

Perfshihu, Merr iniciativen		
1		Kalendari i vendimmarrjes
2		Kalendari i takimeve publike, apo online per buxhetin, paketen fiskale, pronat e bashkise, pronat e bashkise, per projekte me ndikim ne mjedis, per normat, standartet e sherbime, per strategjite, planet e bashkise
3		Akte për të cilët është i detyrueshem zhvillimi i konsultimit publik.
4		Procedura e marrjes dhe shqyrtimit të komenteve dhe rekomandimeve
5		Rregjistri i projektakteve per konsultim me publikun
6		Njoftimi për nismën vendimmarrëse me pjesëmarrje
7		Kalendari i degjesave publike ne mbledhjet e KB, Komisioneve (ceshtja, data)
8		Procedurat për të bërë një ankim në lidhje me konsultimin publik
9		Peticionet, Iniciativat qytetare: formatet, procedurat, afatet (linku per rregulloren e KB, link per shkarkim i formateve)
10		Regjistri i peticioneve, iniciativave (linku per shkarkimin e regjistrit)
11		E drejta e ankimit (formatet, procedurat, afatet)
12		Afati i neshkrimeve, nr minimal I neshkrimeve te nevojshme (iniciativat)
13		Adresa postare/ elektronike për depozitimin e iniciativës qytetare.

14		Kalendari i degjesave publike per petitionet, iniciativat (data, ora, vendi, ceshtja e petitionit/ initiatives)
15		e-Peticionet
16		Anketat, Sondazhe elektronike
17		Pyetesore elektronike
18		Raportet e pyetesoreve, anketave, sondazheve elektronike
19		Forume, Panele elektronike
20		Log-in: grup-mosha, gjinia, territori, ceshtja, statusi (<i>qytetar, biznes, OJF, akademi</i>)
	Kontakto Keshillin	
1		Regjistrohu per ne mbledhjet e KB (formati, procedura, afati)
2		Dergo fjalen tende (email, sms, app in mobile of webpage)
3		Kontakto keshilltaret (cel, facebook, twitter, blog, etj)
	Ankesat dhe Kerkesat e Pergjithshme	
1		Regjistri i ankesave dhe kerkesat e pergjithshme (link)
2		Formatet, procedurat, afatet per dorezimin e ankeses, kerkeses se pergjithshme

Komitetet dhe Bordet e Qytetareve		
1		Emertesat, funksionet, detyrat
2		Anetaret, Regjistri i anetareve
3		Vendimet
Strukturat komunitare		
1		Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e strukturave komunitare; funksionet dhe detyrat
2		Kryesite e fshatrave -KF (hartat për çdo fshat)
3		Anetaret, Kryetari i fshatit (kontaktet), komisionet e KF
4		Mbledhjet e KF (njoftimet, axhenda)
5		Vendimet dhe rezultatet e votimeve të KF
6		Këshillat komunitare të lagjeve KK, përshkrimi (hartat për KK)
7		Anetaret, Nderlidhësi komunitar (kontaktet), komisionet e KK
8		Mbledhjet e KK (njoftimet, axhenda)
9		Vendimet dhe rezultatet e votimeve të KK

	Te dhena e Hapura	
1		Statistika, Dashboards
2		Regjistrat (akteve, p/akteve, kerkesave per info , etj)
	Njoftimet	
1		Njoftimet per qytetaret, bizneset, vizitoret
	Pyetje & Pergjigje	
1		Pyetje & Pergjigje me te shpeshta
III. LLOGARIDHENJA DHE PERFORMANCA		
	Dokumentet e politikave dhe Raportet	
1		Plani vjetor i punes i KB
2		Planet sektoriale te KB (plani i trajnimeve, strategjia e komunikimit etj)
3		Buxheti i KB
4		Raporti vjetor i veprimtarise se KB
5		Raporti vjetor i zbatimit te buxhetit te KB
6		Raporti vjetor i procesit te vendimmarrjes
7		Raporti i pjesemarrjes se keshilltareve ne mbledhjet e KB
8		Raporti vjetor per ankesat kerkesat dhe dashboard
9		Raporti vjetor i kerkesave per informacion

10		Buxheti per Qytetarin
11		Performanca e buxhetit: dashboards (ardhurat, shpenzimet, investimet)
12		Performanca e sherbimeve: dashboards
13		Treguesit e performances KB
14		Anketa per vleresimin e performanes se KB nga qytetaret
IV.	EDUKIMI I PUBLIKUT	
1		Udhezues
2		Fletepalosje
3		Spote, webcast edukative
		<i>Procesi I vendimmarrjes se KB, Procesi i konsultimit te buxhetit</i>
		<i>Si te kontribosh ne vendimmarjen per bashkine, etj.</i>
V.	MEDIA & LAJMET	
1		Lajmet rreth KB
2		Deklaratat per shtyp te KB (ceshtja, viti)
5		Videoteka e mbledhjeve të KB
6		Media sociale e KB (links)
7		Galeria e fotove
8		Kontaktet per median